



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 100/4 Prot.

Tiranë, më 28.04.2017

**V E N D I M**

Nr.110, datë 28/04/2017

***"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 81, datë 19.07.2016 dhe ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të emërimeve nga institucioni i Bashkisë Mallakastër, prej datës 27.04.2016 e në vazhdim"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenin 34 e vijues të Rregullores, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 81, datë 19.07.2016, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 334, prot., datë 18.04.2016", në institucionin e Bashkisë Mallakastër,

**VËREJ SE:**

Me Urdhrin nr. 334, prot., datë 18.04.2016, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në Bashkinë Mallakastër. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 81, datë 19.07.2016, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 334, prot., datë 18.04.2016", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Fillimisht, njësia përgjegjëse duhet të përcaktojë pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil në bashki dhe në njësitë administrative në varësi të saj, duke u bazuar në funksionet dhe detyrat konkrete të vendeve të punës përkatëse, të përcaktuara në formularin e përshkrimit të punës, të cilat duhet të ushtrojnë funksione publike, duke përjashtuar rastet e përcaktuara në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Ky proces duhet të materializohet në strukturën e institucionit miratuar nga Kryetari i Bashkisë me Urdhrin nr. 49/1, datë 16.03.2016, duke u specifikuar në mënyrë të shprehur "Pozicion pune në shërbim civil".

2. Njësia përgjegjëse, për 5 punonjësit (\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*) dhe \*\*\*\*\*), për të cilët nga verifikimi i materializuar me raportin nr. 870/1, datë 15.09.2015, “Për verifikimin e marrëdhënieve të punës së personelit të Bashkisë Mallakastër dhe 8 Njësive Administrative, si pasojë e ristrukturimit të institucionit”, të njësive përgjegjëse, rezultuan se i plotësojnë kushtet për të qenë nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, në kategorinë e nëpunësit civil.
3. Pas përfundimit të proceseve më sipër, njësia përgjegjëse, për plotësimin e pozicioneve të punës, të cilat rezultojnë të lira në kuptim të ligjit duhet të ndjekë këtë rend veprimesh:
  - a) Së pari, të verifikojë nëse ndonjë prej punonjësve, nga 8 (tetë) ish-Komunat apo ish-Bashkia Ballsh (që aktualisht titullohet Mallakastër), të cilët kanë qenë të punësuar në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për shërbimin civil”, i ndryshuar dhe që në kuptim të nenit 67, pika 3, të këtij ligji e gëzojnë statusin e nëpunësit civil e i plotësojnë kërkesat për të punuar në ndonjë prej pozicioneve të lira dhe të kryejë emërimin e tyre pa konkurrin në atë pozicion.
  - b) Së dyti, të verifikojë listën e nëpunësve civilë të dalë pas ristrukturimit të institucionit dhe nëse ndonjë prej tyre plotëson kërkesat e vendit të punës, për të punuar në ndonjë prej pozicioneve të lira, të emërohet në atë pozicion pa konkurrin.
  - c) Së treti, pasi të ketë ezauruar dy hapat e parë, të shpallë procedurat e konkurrimit për pozicionet që do të rezultojnë ende të lira.
4. Njësia përgjegjëse të hartojë planin e veprimit, për të zhvilluar procedurat e konkurrimit, miratuar me aktin nr. 631, datë 14.04.2016, “Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbim civil, për vitin 2016”, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, për pozicionet që do të mbeten të lira, zbatimi i të cilit do të monitorohet në kohë reale nga përfaqësuesit e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
5. Njësia përgjegjëse, pasi të ketë përfunduar procesin e verifikimit të deklarimit të statusit të punësimit për të gjithë ata punonjës, të cilët në momentin e fillimit të efekteve të ligjit ishin të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, në institucion, duhet të revokojë aktet administrative, të cilët kanë dalë në kundërshtim me ligjin, për emërimin e përkohshëm të 44 punonjësve, si më poshtë:
  1. Të revokojë aktin nr. 81, datë 07.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 588/2 prot.), për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist muzike, në Drejtorinë e Çështjeve Sociale”;
  2. Të revokojë aktin nr. 81, datë 07.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 588/3 prot.), për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist i sporteve, në Drejtorinë e Çështjeve Sociale”;
  3. Të revokojë aktin nr. 81, datë 07.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 588/4, prot.), për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist turizmi, në Drejtorinë e Çështjeve Sociale”;
  4. Të revokojë aktin nr. 81, datë 07.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 588/5, prot.), për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist, në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit”;

5. Të revokojë aktin nr. 81, datë 07.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 588/6, prot.), për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist, në Sektorin e Tatim –Taksave”;
6. Të revokojë aktin nr. 81, datë 07.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 588/7, prot.), për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist zyre, në Sektorin Juridik”;
7. Të revokojë aktin nr. 81, datë 07.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 588/7, prot.), për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist i Arkivës, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Arkivi dhe Protokolli”;
8. Të revokojë aktin 197, datë 21.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 1724/2, prot.), për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Drejtor, në Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike”;
9. Të revokojë aktin nr. 197, datë 21.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 1724/3, prot.), për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në detyrën “Drejtor, në Drejtorinë Juridike dhe Marrëdhënieve me Publikun”;
10. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Përgjegjës i Sektorit të Auditit të brendshëm”;
11. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist Auditit, në Sektorin e Auditit të brendshëm”;
12. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist për ndihmën ekonomike, në Sektorin e Shërbimit Social të Integruar, Drejtoria e Çështjeve Sociale”;
13. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist për dhunën në familje, mbrojtjen e fëmijëve, çështjet gjinore, mbrojtjen sociale, në Sektorin e Shërbimit Social të Integruar, Drejtoria e Çështjeve Sociale”;
14. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist i Muzeut, në Sektorin e Kulturës, Turizmi dhe Sporteve, Drejtoria e Çështjeve Sociale”;
15. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist i muzikës, në Sektorin e Kulturës, Turizmit dhe Sporteve, Drejtoria e Çështjeve Sociale”;
16. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist Biblioteke, Sektori i Kulturës, Turizmit dhe Sporteve, Drejtoria e Çështjeve Sociale”;
17. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Përgjegjës në Sektorin e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik, Drejtoria e Infrastrukturës dhe e Shërbimeve Publike”;
18. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist, në Sektorin e Pastrimit të Gjellbërimit, Shërbimit Funeral dhe Mirëmbajtjes së Varrezave, Drejtoria e Infrastrukturës dhe e Shërbimeve Publike”;
19. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Përgjegjës i Sektorit të Pastrimit Gjellbërimit, Shërbimit Funeral dhe Mirëmbajtjes së Varrezave, Drejtoria e Infrastrukturës dhe e Shërbimeve Publike”;
20. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në detyrën “Drejtor, në Drejtorinë e Mjedisit”;

21. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist kadastre, në Sektorin e Menaxhimit të Tokës Bujqësore, Drejtoria e Mjedisit”;
22. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shërbimet Veterinare, në Sektorin e Menaxhimit të Tokës Bujqësore, Drejtoria e Mjedisit”;
23. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Territorit dhe i Projektimit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit”;
24. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist, në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Projektimit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit”;
25. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Drejtore i Drejtorisë Ekonomike”;
26. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Përgjegjës i Sektorit të Financës, Drejtoria Ekonomike”;
27. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist, në Sektorin e Tatim Taksave, Drejtoria Ekonomike”;
28. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist, në Sektorin Juridik, Drejtoria Juridike dhe Marrëdhëniet me Publikun”;
29. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist për Marrëdhëniet me Publikun, në Sektorin Juridik, Drejtoria Juridike dhe Marrëdhëniet me Publikun”;
30. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist i Burimeve Njerëzore, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Arkivi, Protokolli, IT, Drejtoria Juridike dhe Marrëdhëniet me Publikun”;
31. Të revokojë kontratën nr. L 439/1, prot, datë 16.03.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist protokolli, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Arkivi, Protokolli, IT Drejtoria Juridike dhe Marrëdhëniet me Publikun”;
32. Të revokojë aktin nr. 70/1, datë 01.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 546/3, prot.), për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Përgjegjës i Sektorit të Kujdesit Social, Mbrojtjes Civile dhe Punësimit, Drejtoria e Kulturës, Sportit dhe Çështjeve Sociale”;
33. Të revokojë aktin nr. 70/1, datë 01.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 546/4, prot.), për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Përgjegjës i Sektorit të Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Turizmit, Drejtoria e Çështjeve Sociale”;
34. Të revokojë aktin nr. 70/1, datë 01.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 546/5, prot.), për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Përgjegjës i Sektorit të Statistikave dhe i Gjendjes Civile, Drejtoria Juridike dhe Marrëdhëniet me publikun”;
35. Të revokojë aktin nr. 70/1, datë 01.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 546/6, prot.), për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Tokës Bujqësore, Drejtoria e Menaxhimit të Pyjeve, Mjedisit dhe Tokës Bujqësore”;
36. Të revokojë aktin nr. 70/1, datë 01.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 546/7, prot.), për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Përgjegjës i Sektorit për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shërbimet Veterinar, Drejtoria e Menaxhimit te Pyjeve, Mjedisit dhe Tokës Bujqësore.”;

37. Të revokojë aktin nr. 70/1, datë 01.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 546/8, prot.), për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Arkivit Protokollit, Drejtoria Juridike dhe e Marrëdhënieve me Publikun”;
  38. Të revokojë aktin nr. 70/1, datë 01.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 546/9, prot.), për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në detyrën “Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit”;
  39. Të revokojë aktin nr. 97, datë 03.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 740/3, prot.), për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në detyrën “Specialiste Finance në Sektorin e Financës, Drejtoria Ekonomike”;
  40. Të revokojë aktin nr. 33, datë 03.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 740/4, prot.), për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* emëruar në detyrën “Specialist, në Sektorin e Tatim –Taksave, Drejtoria Ekonomike”;
  41. Të revokojë aktin nr. 88, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 659/1, prot.), për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist zyre, IMTV”;
  42. Të revokojë aktin nr. 88, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 659/2, prot.), për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist transporti, në Sektorin e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik, Drejtoria e Infrastrukturës dhe e Shërbimeve Publike”;
  43. Të revokojë aktin nr. 88, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 659/3, prot.), për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist i Trashëgimisë Natyrore, në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit, Drejtoria e Menaxhimit të Pyjeve, Mjedisit dhe Tokës Bujqësore”;
  44. Të revokojë aktin nr. 88, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë (shoqëruar me kontratën nr. 659/4, prot.), për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në detyrën “Specialist Jurist, në Sektorin Juridik, Drejtoria Juridike dhe e marrëdhënieve me publikun”.
6. Njësia përgjegjëse, të plotësojë pozicionet e punës që mbeten të lira, me anën e procedurave të konkurrimit të hapur sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, si procedura që përfaqësojnë sistemin e karrierës në shërbimin civil.
  7. Njësia përgjegjëse gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike. Në veçanti, njësia përgjegjëse të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:
    - a) Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimit dhe vlerësimit (Komiteti i Përhershëm i Pranimit për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës pjesë të shërbimit

civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (përveç lëvizjes paralele) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.

b) Të bëjë publike në faqen zyrtare, “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të Bashkisë Mallakastër, ose nëse është e mundur, në stendat për publikun, shpalljet si:

- Aktin e shpalljes për të plotësuar një pozicion të lirë pune në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat, e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreu III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; pranim në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit (arsimi i lartë përkatës); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjor që duhet të përmbajë shpallja.
- Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele” ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.
- Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (lista përfundimtare) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele” ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.
- Aktin e shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.

8. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Mallakastër, të zbatojë vendimin brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me aktet përkatëse, që materializojnë veprimet administrative përkatëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar Nr. 81, datë 19.07.2016, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Bashkisë Mallakastër, prej datës 27.04.2016 që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, me Vendimin Nr. 22, datë 10.02.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 81, datë 19.07.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Bashkia Mallakastër, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 27.04.2016 e në vazhdim”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 81 datë 19.07.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 334, prot., datë 18.04.2016”.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Bashkisë Mallakastër, dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 100/2 prot., datë 10.02.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Bazuar në procesverbalin e mbajtur me datë 13.02.2017 nga grupi i punës i Komisionerit dhe nënshkruar edhe nga personat e kontaktit të institucionit të Bashkisë Mallakastër, dhe pas shqyrtimit të materialeve shkresore të administruara në përfundim të procesit të verifikimit, rezultoi sa më poshtë vijon:

Në zbatim të rekomandimeve të dhëna në Vendimin Nr. 81, dt.19.07.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Kryetari i Bashkisë Mallakastër ka nxjerrë aktin administrativ nr. 208, dt.24.8.2016, *“Për zbatimin e Vendimit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”*.

- Në lidhje me përcaktimin e pozicioneve të punës pjesë të shërbimit civil në bashki dhe njësitë administrative në varësi të saj (pika 1 e Vendimit të Komisionerit), njësia përgjegjëse, bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 6, dt.02.03.2016 dhe në zbatim të Vendimit Nr. 165, dt.02.03.2016, *“Për grupimin e njësisve të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësisve të qeverisjes vendore”*, të Këshillit të Ministrave, ka materializuar në strukturën e institucionit, pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil sipas funksioneve dhe detyrave konkrete të përcaktuara në formularin e përshkrimit të punës. Po kështu është miratuar Plani Vjetor i Pranimit në Shërbimin Civil, sipas përcaktimeve të Vendimit nr.108, dt. 26.02.2014 *“Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”*, të Këshillit të Ministrave.
- Për 5 punonjësit për të cilët në pikën 2 të vendimit, është kërkuar nxjerrja e akteve të deklaramit të statusit të punësimit në përputhje me periudhën e punësimit që mbanin në pozicionet në të cilat i gjeti hyrja në fuqi e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, njësia përgjegjëse e Bashkisë Mallakastër ka nxjerrë:
  - aktet e deklaramit të statusit të punësimit *“nëpunës civil”* për:
    1. \*\*\*\*\* - *“Specialiste e PAK”* në Drejtorinë e Çështjeve Sociale
    2. \*\*\*\*\* - *“Specialist”* në Drejtorinë e Mjedisit
  - aktet e deklaramit të statusit të punësimit *“nëpunës civil në periudhë prove”* për:
    1. \*\*\*\*\* - *“Specialiste”* në Sektorin Juridik;
    2. \*\*\*\*\* - *“Specialiste”* në Sektorin e Auditit.

Punonjësi \*\*\*\*\* bazuar në nenin 66, pika 1, gërma *a* të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, është liruar nga shërbimi civil, pas refuzimit të tij për t’u transferuar në një pozicion tjetër të shërbimit civil, pas procesit të rsitrukturimit të institucionit, Bashkia Mallakastër. Vendimi i lirimt është bërë objekt ankimi në gjykatë, por kjo e fundit e ka rrëzuar kërkesën e \*\*\*\*\*.

- Në zbatim të pikave 3 dhe 4, njësia përgjegjëse, pasi ka verifikuar statusin e punonjësve të ish-komunave, nëse plotësonin apo jo kriteret për të qenë nëpunës civil, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, me aktin nr.1309 prot., dt.15.07.2016 (Vendimi Nr.159, dt.15.07.2016) ka miratuar *“Planin vjetor të pranimeve në shërbimin civil për vitin 2016”*.

- Në lidhje me rekomandimin e pikës 5, njësia përgjegjëse, në përputhje me planin e pranimit, ka filluar procedurat e rekrutimit në nivel ekzekutiv për 31 pozicione të lira pune të klasifikuara në 17 grupe administrimi, sipas përcaktimeve të nenit 22 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr.243, dt.18.03.2015, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave. Shpalljet e pozicioneve të lira të punës janë bërë në Shërbimin Kombëtar të Punësimit me shkresën nr.1384, dt.18.07.2016, si dhe në këndin e afishimit të njoftimeve në Bashkinë Mallakastër në përputhje me vendimin e sipërcituar.

Me përfundimin e procedurës së konkurrimit për pozicionet e mësipërme janë shpallur fitues 22 konkurrues (nga të cilët, 16 fitues bëjnë pjesë tek punonjësit e emëruar përkohësisht, për të cilët është kërkuar revokimi i akteve të përkohshme të emërimit) dhe rezultatet e konkursit për kualifikimin e fituesve përfundimtarë i janë dërguar Shërbimit Kombëtar të Punësimit me shkresën nr.1486, dt.08.08.2016.

Për nëpunësit e mëposhtëm, të cilët janë emëruar “Nëpunës civil në provë”, pas përfundimit të procedurës së konkurrimit, konsiderohen të revokuara aktet administrative të emërimit të tyre në kundërshtim me ligjin, sipas rekomandimit të pikës 5 të vendimit:

1. \*\*\*\*\* emërohet “nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin “Specialist” në Drejtorinë e Çështjeve Sociale;
2. \*\*\*\*\* emërohet “nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin “Specialist” në Sektorin e Pyjeve dhe Mjedisit;
3. \*\*\*\*\* emërohet “nëpunëse civile në periudhë prove” në pozicionin “Specialiste” në Sektorin e Financës;
4. \*\*\*\*\* emërohet “nëpunëse civile në periudhë prove” në pozicionin “Specialiste” në Sektorin Juridik;
5. \*\*\*\*\* emërohet “nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin “Specialist arkive” në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Arkivit, Protokollit dhe IT;
6. \*\*\*\*\* emërohet “nëpunëse civile në periudhë prove” në pozicionin “Specialiste” në Sektorin e Auditit të Brendshëm;
7. \*\*\*\*\* emërohet “nëpunëse civile në periudhë prove” në pozicionin “Specialiste” në Sektorin e Shërbimit Social të Integruar;
8. \*\*\*\*\* emërohet “nëpunëse civile në periudhë prove” në pozicionin “Specialiste” në Sektorin e Shërbimit Social të Integruar;
9. \*\*\*\*\* emërohet “nëpunëse civile në periudhë prove” në pozicionin “Specialiste” në Sektorin e Kulturës, Turizmit dhe Sporteve;
10. \*\*\*\*\* emërohet “nëpunëse civile në periudhë prove” në pozicionin “Specialiste” në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Shërbimit Veterinar;
11. \*\*\*\*\* emërohet “nëpunëse civile në periudhë prove” në pozicionin “Specialiste” në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Projektimit;
12. \*\*\*\*\* emërohet “nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin “Specialist” në Sektorin e Tatim-Taksave;
13. \*\*\*\*\* emërohet “nëpunëse civile në periudhë prove” në pozicionin “Specialiste” në Sektorin Juridik;
14. \*\*\*\*\* emërohet “nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin “Specialist” i marrëdhënieve me publikun në Sektorin Juridik;



15. \*\*\*\*\* emërohet “*nëpunëse civile në periudhë prove*” në pozicionin “*Specialiste buxheti*” në Sektorin Financës;
16. \*\*\*\*\* emërohet “*nëpunës civil në periudhë prove*” në pozicionin “*Specialist*” në Sektorin Mirëmbajtjes së dhe Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik;

Përsa i përket revokimit të akteve administrative për punonjësit e mëposhtëm, nga ana e njësisë përgjegjëse nuk është vepruar, sepse, bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 6, dt.02.03.2016, pozicionet e tyre të punës nuk përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil. Më konkretisht bëhet fjalë për punonjësit:

1. \*\*\*\*\* Specialist muzike;
2. \*\*\*\*\* Specialist i sporteve;
3. \*\*\*\*\* Specialist muzike;
4. \*\*\*\*\* Punonjës biblioteke;
5. \*\*\*\*\* Përgjegjës në Sektorin e Infrastrukturës Publike;
6. \*\*\*\*\* Specialist në Sektorin e Pastrim Gjellbërimit;
7. \*\*\*\*\* Përgjegjës në Sektorin e Pastrim Gjellbërimit;
8. \*\*\*\*\* Topograf në Sektorin e Menaxhimit të Tokës;
9. \*\*\*\*\* Specialist në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit.

Në zbatim të pikës 5, të vendimit të Komisionerit, Kryetari i Bashkisë Mallakastër, në datë 25.08.2016, ka nxjerrë urdhra të brendshëm individualë për revokimin e kontratave të punës në zbatim të vendimit për punonjësit:

1. \*\*\*\*\* Drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike (*Urdhri nr.210, dt.25.8.2016*);
2. \*\*\*\*\* Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Marrëdhëniet me Publikun (*Urdhri nr.211, dt.25.8.2016*);
3. \*\*\*\*\*Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm (*Urdhri nr.212, dt.25.8.2016*);
4. \*\*\*\*\* Drejtor i Drejtorisë së Mjedisit (*Urdhri nr.213, dt.25.8.2016*);
5. \*\*\*\*\* Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Territorit dhe Projektimit (*Urdhri nr.214, dt.25.8.2016*);
6. \*\*\*\*\* Drejtor i Drejtorisë Ekonomike (*Urdhri nr.215, dt.25.8.2016*);
7. \*\*\*\*\* Përgjegjës i Sektorit të Financës në Drejtorinë Ekonomike (*Urdhri nr.216, dt.25.8.2016*);
8. \*\*\*\*\* Specialist Protokoll në Sektorin e Burimeve Njerëzore IT (*Urdhri nr.217, dt.25.8.2016*);
9. \*\*\*\*\* Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Social të Integruar (*Urdhri nr.218, dt.25.8.2016*);
10. \*\*\*\*\* Përgjegjës i Sektorit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (*Urdhri nr.219, dt.25.8.2016*);
11. \*\*\*\*\* Përgjegjës i Sektorit të Gjendjes Civile dhe Statistikave (*Urdhri nr.220, dt.25.8.2016*);
12. \*\*\*\*\* Përgjegjës i Sektorit të Konsumatorit dhe Veterinarisë (*Urdhri nr.221, dt.25.8.2016*);
13. \*\*\*\*\* Përgjegjës i Sektorit të Tokës Bujqësore (*Urdhri nr.222, dt.25.8.2016*);
14. \*\*\*\*\* Drejtor i Drejtorisë Planifikimit të Territorit dhe Projektimit (*Urdhri nr.223, dt.25.8.2016*);

15. \*\*\*\*\* Përgjegjës i Sektorit të Arsimit dhe Shëndetësisë (*Urdhri nr.224, dt.25.8.2016*);
16. \*\*\*\*\* Përgjegjës i Sektorit Juridik (*Urdhri nr.225, dt.25.8.2016*);
17. \*\*\*\*\* Specialiste e Burimeve Njerëzore (*Urdhri nr.226, dt.25.8.2016*);

Njësia e Burimeve Njerëzore, me shkresën nr. 1309/2, dt.22.7.2016, ka propozuar plotësimin e 10 pozicioneve të lira të punës dhe ky propozim u miratua me Vendimin nr.159/1, dt. 15.07.2016, “*Plani vjetor i Pranimeve në Shërbimin Civil për vitin 2016*”, të titullarit të institucionit dhe më pas me shkresën nr.1577, dt.25.7.2016, njoftimet i janë dërguar nëpërmjet shërbimit postar, Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Pozicionet e shpallura janë si më poshtë:

1. Përgjegjës Sektori në Sektorin e Kulturës, Turizmit dhe Sporteve në Drejtorinë e Çështjeve Sociale;
2. Përgjegjës Sektori në Sektorin e Shërbimit Social të Integruar në Drejtorinë e Çështjeve Sociale;
3. Drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike;
4. Drejtor i Drejtorisë së Mjedisit;
5. Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit;
6. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike;
7. Përgjegjës i Sektorit të Tatim-Taksave në Drejtorinë Ekonomike;
8. Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Marrëdhënieve me Publikun;
9. Përgjegjës i Sektorit Juridik në Drejtorinë Juridike dhe Marrëdhëniet me Publikun;
10. Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Tokës Bujqësore në Drejtorinë e Mjedisit.

Nga verifikimi në subjekt rezultoi se punonjësi N. Koraj, për të cilin është kërkuar gjithashtu revokimi i aktit administrativ të emërimit të përkohshëm në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Arkiv-Protokollit, Drejtoria Juridike dhe e Marrëdhënieve me Publikun*”, ka kaluar sërish me emërim të përkohshëm nga ky pozicion në pozicionin “*Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Pyjeve*”, pranë Bashkisë Mallakastër.

Për këtë arsye, në Vendimin Nr. 87, datë 18.04.2017, “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin nr. 22, datë 10.02.2017*”, Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër të anulojë pikën 1 të aktit administrativ nr. 204, datë 18.08.2016, që emëron këtë punonjës në pozicionin e sipërpërmendur, zbatimi i të cilit do të ndiqet më vonë nga Komisioneri me mbarimin e afatit të përcaktuar në dispozitivin e vendimit.

Ndërsa për punonjësin Elson Hoxhaj, me detyrë “*Specialist, në Sektorin e Tatim –Taksave, Drejtoria Ekonomike*”, aktualisht rezulton se ka kaluar në pozicion pune jashtë shërbimit civil.

- Në lidhje me pikat 6 dhe 7 të vendimit, njësia përgjegjëse ka plotësuar pozicionet e punës që kanë mbetur të lira, me anën e procedurave të konkurrimit të hapur sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij.

Gjithashtu, njësia përgjegjëse gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit ka përmbushur rregullat e përcaktuara në kreun IV “*Pranimi në shërbim civil*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015,

të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin Nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike. Gjithë këto veprime administrative shoqërohen me dokumentacionin përkatës, të administruar nga grupi i punës.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 81 datë 19.07.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 334, prot., datë 18.04.2016”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Mallakastër janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenin 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe 34 të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit Nr. 81, datë 19.07.2016 në institucionin e Bashkisë Mallakastër.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Mallakastër, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 81, datë 19.07.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 334, prot., datë 18.04.2016”.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Mallakastër, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**